



**PROF. ASSOC. DR.
VERA BUSHATI**

Lektore në departamentin
e Arkitekturës në Fakultetin e
Shkencave të Aplikuara
dhe Industrive Kreative.

KONTAKTE

✉ v.bushati@umb.edu.al



**PROF. ASSOC. DR.
VERA BUSHATI**

Lektore në departamentin
e Arkitekturës në Fakultetin e
Shkencave të Aplikuara
dhe Industrive Kreative.

BIOGRAFIA

Prof. Asoc. Dr. Vera Bushati është arkitekte dhe anëtare e Adriapol dhe koordinatore e Forumeve të Hapura pranë Universitetit Barleti. Në vitin 1969, ajo u diplomua në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin e Tiranës (UT, tani UPT), në fushën e arkitekturës dhe ndërtimit, me një diplomë me vlerësimin maksimal & shkëlqyer.

Karriera e saj profesionale nisi në kompaninë e ndërtimit Lushnjë fillimisht si inxhinierë dhe më pas si kryeinxhinierë, pozicion që e mbajti deri në vitin 1974. Më pas, ajo vazhdoi karrierën akademike në Universitetin e Tiranës, ku punoi si pedagoge në lëndët Teknologjia e Ndërtimit dhe Historia e Arkitekturës dhe Qytetit, nga viti 1974 deri në vitin 1992.

Përveç mësimdhënies, Prof. Asoc. Dr. Vera Bushati ka mbajtur ligjërata mbi Historinë e Arkitekturës Shqiptare në disa universitete jashtë vendit, përfshirë Universitetin e Prishtinës, Stokholmin, Marburgun dhe Universitetin Teknik të Vjenës. Ajo gjithashtu ka praktikuar si arkitekte dhe inxhinierë ndërtimi në vende të tjera jashtë Shqipërisë, përfshirë Libanin dhe Kongon. Në vitin 1982, ajo përfundoi me sukses doktoraturën e saj të përqendruar në arkitekturën e banesave ilire dhe aktualisht është lektore në Universitetin Barleti.